

Aktivitetet njerëzore (urbanizimi, bujqësia intensive, prodhimi i energjisë, lidhja e përmirësuar e infrastrukturës dhe ngjashëm) bëjnë presion të madh mbi natyrën dhe shkaktajnë fragmentimin e habitateve natyrore, që paraqet kërcënim të madh për biodiversitetin. Krijimi i rrjeteve ekologjike, si model i ri për ruajtjen e biodiversitetit, konsiderohet si një nga masat më efektive për mbrojtjen e tij, ndërsa mundëson përdorimin e qëndrueshëm të natyrës.

Përmes projektit "Zhvillimi i Rrjetit Ekologjik Nacional" në Republikën e Maqedonisë së Veriut (MAK-NEN), u bë identifikimi dhe hartëzimi i korridoreve ekologjike për të gjithë territorin e vendit, duke e marrë arin si specie kryesore.

Cilat janë aspektet e rëndësishme, që përcaktojnë korridoret ekologjike (të gjelbra):

- ✓ Sigurimi i lëvizjes së lirë dhe komunikimit të specieve të egra;
- ✓ Mundësimi i shkëmbimit të individëve midis popullatave, që mund të ndihmojë në parandalimin e efekteve negative të kryqëzimit dhe zvogëlimin e diversitetit gjenetik;
- ✓ Rivendosja e popullatave që janë zvogëluar ose eliminuar për shkak të ngjarjeve aksidentale, siç janë zjarre ose sëmundje, të cilat kohët e fundit janë bërë dukuri të shpeshta, si rezultat i efekteve të ndryshimeve klimatike;

Në kuadër të rrjetit ekologjik janë përcaktuar 14 zona thelbësore dhe 26 korridore, të rëndësishëm për arin e murrmë (dhe të gjithë gjitarët e mëdhenj):



Në kuadër të projektit aktual GEF / UNEP: "Arritja e ruajtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efektiv të zonave të mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës" (STAR 5), në kuadër të Komponentit 2 - Rritja e efikasitetit të menaxhimit me biodiversitetin, filloi aktiviteti i projektit "Dy pilot korridore të propozuara në Rrjetin Ekologjik Nacional (MAK - NEN) të përzgjedhura për zhvillimin dhe testimin e masave specifike, me përfshirjen e palëve të interesuara lokale, me qëllim përmirësimin e menaxhimit dhe restaurimit të pyjeve me vlera të larta natyrore dhe habitate të tjera".

Qëllimi kryesor i aktivitetit të projektit është të ndihmojë autoritetet shtetërore përkatëse në drejtim të përmirësimit të lidhjes së zonave të mbrojtura, politikave nacionale dhe kapacitetet e menaxhimit të korridoreve të botës së egër.

Qëllimet specifike të projektit janë: përzgjedhja e dy pilot korridoreve, nga ato të propozuara në Rrjetin Ekologjik Nacional (MAK-NEN), në të cilat do të ndërtohej infrastrukturë e gjelbër, e cila do të ishte subjekt i shqyrtimit nga palët e interesuara; ndihmë për qeveritë qendrore dhe lokale, institucionet e menaxhimit të burimeve natyrore, shoqërisë civile dhe ekspertëve të ndërtojnë kapacitete për zhvillimin e udhëzimeve për menaxhim me korridore, si bazë për planifikimin e aktiviteteve të ruajtjes së natyrës (korridoret e zgjedhura) përmes përfshirjes së biodiversitetit në sektorët përkatës.

Në kuadër të projektit do të zbatohen katër aktivitete kryesore në vijim:

1. **Analizë e korridoreve të rrjetit MAK-NEN dhe praktikave rajonale dhe ndërkombëtare për menaxhim me infrastrukturën e gjelbër;**
2. **Konsultime, në nivel nacional, për zgjedhjen e dy pilot korridoreve në të cilët do të duhet të ndërtohet infrastruktura e gjelbër;**
3. **Përgatitja dhe testimi i masave për menaxhim me korridoret e zgjedhura dhe**
4. **Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe prezantimi i rezultateve përfundimtare**

Vlerësimi dhe përzgjedhja e dy korridoreve në kuadër të këtij projekti do të bazohet në kriteret e EU/EPPA Study on Green Infrastructure Deployment and Ecological Connectivity (<https://eppanetwork.eu/taix-eppa-regional-workshop-on-green-infrastructure-and-ecological-connectivity-2/>).



Arritja e ruajtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efektiv të zonave të mbrojtura dhe integrimi i biodiversitetit në planifikimin e përdorimit të tokës

Dy pilot korridore nga të propozuarat në Rrjetin Nacional Ekologjik (MAK-NEN) të përzgjedhura për zhvillimin dhe testimin e masave specifike me përfshirjen e palëve të interesuara lokale, me qëllim përmirësimin e menaxhimit dhe restaurimit të pyjeve me vlera të larta natyrore dhe habitateve të tjera

Në zemër të konceptit për ruajtjen e ekosistemit janë lidhjet dhe bashkëveprimet midis specieve, habitateve dhe burimeve.

Infrastruktura e gjelbër është një koncept i gjerë që duhet të sigurojë integrimin e veçorive të ndryshme natyrore me objektet e infrastrukturës, të cilat duhet të mbështesin shëndetin dhe qëndrueshmërinë e ekosistemeve dhe të kontribuojnë në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e shërbimeve të ekosistemit.

Infrastruktura e gjelbër, promovon planifikim hapësor të integruar përmes identifikimit të zonave me shumë qëllime dhe inkorporimin e masave për restaurimin e habitateve, si dhe planet dhe politikat për përdorimin e tokës.

Një nga shtyllat më të rëndësishme për krijimin e infrastrukturës së gjelbër është Marrëveshja e Gjelbër e BE-së, të cilën Republika e Maqedonisë së Veriut, si një vend kandidat për aderim në Bashkimin Evropian, duhet të zbatojë së bashku me Strategjinë Evropiane të Biodiversitetit për vitin 2030 (EU Biodiversity strategy for 2030) dhe Natura 2000.

